



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr.12, datë 05.04.2024

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“GODINË BANIMI DHE HOTEL 1, 11, 12, 13 DHE 14 KATE MBITOKË ME 2 DHE 3**  
**KATE PARKIM NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “SELITA E VJETËR”,**  
**BASHKIA TIRANË.**

Në mbështetje të neneve, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “ERE Architecture & Contruction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë banimi dhe Hotel 1, 11, 12, 13 dhe 14 kate mbitokë me 2 dhe 3 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Selita e Vjetër”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “ERE Architecture & Contruction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

E DI RAMA



Nënshtuar më datë 10.06/2024

ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELJADA ROKA  
AGJENCIA E SHOQËRISË  
TERRITORIALE  
E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

MINISTER I LINJËS  
MINISTER I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISË  
BELENDA BALI  
REPUBLICA E SHQËRIË  
MINISTRI I TIRANË  
ENERGHIË